




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTRI I ENERGISË DHE INDUSTRIE

V E N D I M



Nr. 226, datë 23.3.2016

P Ë R

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.111, DATË 26.1.2011,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR NJË NDRYSHIM
NË VENDIMIN NR.486, DATË 25.7.2007, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR NDËRPRERJEN E VEPRIMTARISË
SË PËRPUNIMIT TË ANIJEVE QË TRANSPORTOJNË NAFTË, GAZ
DHE NËNPRODUKTE TË TYRE, NË PORTET E DURRËSIT
DHE SHËNGJINIT", TË NDRYSHUAR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 2, të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.111, datë 26.1.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Pika 3 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

"3. Trajtimi i produkteve dhe nënprodukteve të naftës, në këtë port, bëhet në anije dhe ato depozitohen në terminale, të cilat ndërtohen dhe përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi."

b) Pika 4 shfuqizohet.

c) Në pikën 5, fjalët "Terminali depozitues të respektojë..." zëvendësohen me "Terminalet depozituese të respektojnë..."

2. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

NIKO PELESHI

**MINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRIË**

DAMIAN GJIKNURI